

Date: B/06/2019

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; **Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit B. Ndryshimit të kushteve të lejes mjedisore Nr. PN-6674-06-2018, sipas Regjistrimit të QKB dhe Nr. 2811 identifikues, Nr 5464 Prot, date 27.06.2018 sipas Aktit të Miratimit të Agjencise Kombetare të Mjedisit.**
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; **Subjekti "VLLAHEN MINING" Sh.p.k, NIPT: L81515039U.**
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; **Qarku Kukës, Bashkia Has, Njësia Administrative Golaj, Objekti "Vlahën".**
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; **Shfrytëzim i Mineralit Krom, me punime Nëntokë dhe në Sipërfaqe**
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues; **Aktiviteti që ne kërkojmë të kryejmë konsiston në shfrytëzimin e Mineralit Krom në zonen minerare nr. 294/7, Vlahen. Leja Mjedisore që ne disponojmë ka të specifikuar shfrytëzimin me nentokë të mineralit, nderkohe që nga studimet paraprake të kryera nga ana jone, rezultojnë që minerali të jetë shumë afër sipërfaqes, cka na detyron të përdorim të dyja metodat e shfrytëzimit, me nentokë dhe me punime në sipërfaqe (me karriere). Pra ndryshimi i propozuar nga ana jone është vetëm ndryshimi i menyrës së shfrytëzimit nga vetëm me galeri (nentokë) në Shfrytëzim me galeri dhe sipërfaqe (me karriere). Per ndryshimin e propozuar, kemi kryer edhe ndryshimet e nevojshme në projektin e shfrytëzimit, të cilat janë miratuar nga MIE-AKBN. Nuk kemi ndryshime në sipërfaqen/kordinatat e lejes së shfrytëzimit, as në kapacitetet nxjerrëse, por vetëm në teknologjinë dhe menyrën e shfrytëzimit. Per kete aktivitet subjekti është i pajisur me leje shfrytëzimi minerare (Nr. 1860, date 12.07.2018, PN-6779-07-2018).**
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD; **Ndodhet bashkelidhur kesaj kerkese.**
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; **Nuk ka.**
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; **40 dite pune. (AKM).**
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; **info@akm.go.al**

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Z. Saimir Boka

Nr.kontakti

0697416374

